Në seancën e mbajtur më 14 nëntor 2025, Këshilli i Nderit pranë Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, në përbërje: **Ognen Janeski** (kryetar), **Mira Kostiq**, **Aleksandar Samarxhiev** dhe **Besim Shabani**, duke vepruar sipas:

• ankesës së paraqitur nga **Arbnora Memeti**;

• ankesës së paraqitur nga **Rita Behadini**;

• dhe reagimit publik të dorëzuar nga **Platforma për Barazi Gjinore**,

të gjitha lidhur me **paraqitjen e gazetarit Nevrij Ademi në emisionin "Ora 7" në televizionin "Klan Kosova"**, lidhur me rastin e studentes nga Kosova që tragjikisht humbi jetën në Tetovë, pas shqyrtimit të pretendimeve, provave dhe deklaratës me shkrim të dorëzuar nga gazetari, miratoi këtë:

VENDIM

Ankesat e paraqitura nga **Arbnora Memeti** dhe **Rita Behadini** kundër gazetarit Nevrij Ademi **PRANOHEN.**

Këshilli i Nderit konstatoi se me paraqitjen publike të gazetarit në programin e televizionit "Klan Kosova" janë shkelur këta nene të Kodit të Gazetarëve të Maqedonisë:

• **neni 1** – detyrimi për publikimin e informatave të sakta dhe të verifikuara;

• **neni 4** – detyrimi për përdorimin e burimeve relevante dhe të verifikueshme;

• **neni 7** – respektimi i privatësisë, dinjitetit, dhimbjes personale dhe zisë së

viktimës dhe familjes së saj;

- **neni 8** – ndalimi i sensacionalizmit dhe detyrimi për informim të kujdesshëm në raste tragjike dhe të ndjeshme;
- **neni 10** – ndalimi i gjuhës që çon drejt diskriminimit, stigmatizimit dhe viktimizimit sekondar;
- **neni 13** – detyrimi për ndarje të qartë mes fakteve dhe opinioneve.

Këshilli konstatoi se **neni 14 nuk është shkelur,** duke pasur parasysh se paraqitja në fjalë nuk lidhet me proces zgjedhor.

ARSYETIM

Këshilli i Nderit shqyrtoi përmbajtjen e paraqitjes së gazetarit **Nevrij Ademi** në emisionin **"Ora 7"** në televizionin **"Klan Kosova"**, të transmetuar më **6 nëntor 2025**, në të cilin gazetari raporton dhe komenton për vdekjen e një studenteje nga Kosova në Tetovë.

Edhe pse në fillim të paraqitjes vetë gazetari thekson se nuk ekzistojnë informacione zyrtare nga institucionet kompetente, në vazhdim ai paraqet një sërë **pretendimesh të pakonfirmuara, spekulime dhe komente vlerësuese** lidhur me sjelljen e supozuar, jetën private dhe përdorimin e mundshëm të substancave narkotike nga ana e viktimës, duke u thirrur në **"dëshmi nga qytetarët"** dhe burime jorelevante.

Në lidhje me nenin 1 dhe nenin 4 të Kodit

Këshilli vlerësoi se janë paraqitur informacione që nuk janë verifikuar, nuk janë konfirmuar nga burime zyrtare dhe nuk janë të mbështetura me fakte, gjë që bie ndesh me detyrimin për informim të saktë, të përgjegjshëm dhe profesional.

Në lidhje me nenin 7 dhe nenin 8 të Kodit

Këshilli konstatoi se përmes mënyrës së shprehjes dhe përmbajtjes së deklaratave është cenuar dinjiteti dhe privatësia e viktimës, ndërsa ngjarja tragjike është trajtuar në mënyrë që përmban elemente sensacionaliste dhe shqetësuese, pa ndjeshmërinë e nevojshme dhe distancën profesionale.

Në lidhje me nenin 10 të Kodit

Këshilli vlerësoi se formulimet dhe kualifikimet e përdorura kanë **karakter seksist dhe diskriminues**, kontribuojnë në transferimin e fajësisë mbi viktimën dhe krijojnë stigmatizim shtesë, çka përbën formë të viktimizimit sekondar dhe është e papajtueshme me etikën gazetareske.

Në lidhje me nenin 13 të Kodit

Këshilli konstatoi se gazetari nuk ka bërë dallim të qartë ndërmjet fakteve dhe mendimeve personale, ku komentet vlerësuese janë paraqitur si informacione, pavarësisht pranimit publik se bëhet fjalë për të dhëna jozyrtare.

NË LIDHJE ME REAGIMIN PUBLIK

Këshilli i Nderit shqyrtoi edhe reagimin publik të dorëzuar nga **Platforma për Barazi Gjinore**, dhe e vlerëson atë si kontribut legjitim në debatin publik mbi raportimin profesional, etik dhe të ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore. Pretendimet e paraqitura në reagim janë në përputhje me vlerësimet e Këshillit lidhur me shkeljet e Kodit dhe tregojnë për dëmin më të gjerë publik që mund të rrjedhë nga praktika të tilla mediatike.

VËREJTJE PUBLIKE

Duke pasur parasysh se brenda një viti kalendarik janë konstatuar **dy shkelje të ndara** të Kodit të Gazetarëve të Maqedonisë, të lidhura me dy përmbajtje të ndryshme mediatike (publikim në portalin **"TetovaSot"** dhe paraqitje në televizionin **"Klan**

Kosova"), Këshilli i Nderit, në përputhje me **nenin 21** të Rregullores për zgjedhjen dhe punën e Këshillit të Nderit, shqipton **vërejtje publike** ndaj gazetarit **Nevrij Ademi**.

Këshilli paralajmëron se, nëse në të ardhmen merret edhe një vendim tjetër negativ për shkelje të Kodit lidhur me një përmbajtje të re, të tretë mediatike brenda të njëjtit vit kalendarik, do të jetë i detyruar të përcaktojë propozim
për **përjashtim nga anëtarësia në SHGM**, në përputhje me aktet në fuqi.

DEKLARATA E GAZETARIT

Këshilli i Nderit mori në konsideratë edhe kërkimfaljen dhe sqarimin me shkrim të dorëzuar nga gazetari **Nevrij Ademi** në SHGM, në të cilën ai deklaron se një pjesë e shprehjeve të përdorura gjatë paraqitjes kanë qenë **"lapsus i pafat"** dhe nuk pasqyrojnë qëndrimin e tij profesional dhe personal. Edhe pse Këshilli e vlerëson këtë veprim si hap pozitiv, ai vlerësoi se serioziteti i përmbajtjeve të paraqitura dhe dëmi publik kërkojnë reagim të qartë institucional dhe përcaktim të përgjegjësisë.

Vendimi do të publikohet në faqen e internetit të **Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë.**

Vendosur në Shkup, 14 nëntor 2025

Këshilli i Nderit pranë SHGM-së

kryetar: Ognen Janeski

anëtarë: Mira Kostiq, Aleksandar Samarxhiev, Besim Shabani,

Emilija Misirlievski (mungon me arsye)